



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**ZP. Anr.52/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 30.12.2025, merr këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa ZP. Anr.52/2025, e datës 28.12.2025, parashtruar nga Subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 28 Dhjetor 2025.

**A r s y e t i m**

Me datë 28.12.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se me datë me datë 27.12.2025, Përparim Rama në cilësinë e Kryetarit të Prishtinës, ka publikuar dhe shpërndarë një video-mesazh politik nga hapësira e zyrës së tij, e cila përbën pronë publike, ku ka bërë thirrje të drejtpërdrejtë për mbështetje dhe votim të kandidatit Shkëmb Manaj dhe të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës. Deklaratat në këtë video përbëjnë thirrje të qartë elektorale, me qëllim ndikimin e drejtpërdrejtë në vullnetin e votuesve, dhe janë bërë jo në cilësi private, por nga një zyrtar i lartë publik dhe nga hapësira institucionale e Kryeqytetit. Neni 36 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ndalon shprehimisht shfrytëzimin e zyrave, mjeteve, resurseve dhe pasurisë publike për qëllime të fushatës zgjedhore, me qëllim garantimin e barazisë së garës zgjedhore dhe neutralitetit të institucioneve publike. Në rastin konkret, plotësohen kumulativisht të gjitha elementet e shkeljes ligjore: së pari, hapësira nga e cila është bërë thirrja është zyrë zyrtare e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, e cila financohet, mirëmbahet dhe administrohet me

mjete publike, dhe si e tillë përbën pasuri publike në kuptim të nenit 36 të Ligjit. Së dyti, përmbajtja e deklaratës është e natyrës qartazi elektorale, pasi përmban promovim të një kandidati të caktuar dhe të një subjekti politik, si dhe thirrje eksplicite për fitore elektorale. Së treti, pozita e deklaruesit është ajo e një zyrtari të lartë publik, i cili gëzon autoritet institucional dhe ndikim politik, çka e bën përdorimin e ambientit zyrtar edhe më problematik nga aspekti i barazisë së garës dhe parimit të mos-abuzimit me funksionin publik. Praktika e PZAP-it ka theksuar se ndalesa e nenit 36 lidhet me përdorimin e hapësirës publike, kur ajo shfrytëzohet për të dhënë mesazhe politike të njëanshme gjatë fushatës zgjedhore. Prandaj, kërkojmë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa që të shqiptojë masat ndëshkuese të parapara me ligj ndaj subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës. Si dëshmi ka bashkangjitur një video CD.

Në përgjigje në ankesë të subjekti politik LDK përmes kësaj përgjigje në ankesë hedh poshtë pretendimet e ankueses Lëvizja Vetëvendosje sa i përket ankesës nr. 52/2025, ngase video nga ku Përparim Rama ka mbështetur kandidatin për deputet nga radhët e LDK Shkëmb Manaj është postuar me date 16.12.2025, rrjedhimisht ankesa e ushtruar me datë 28.12.2025 konsiderohet e pasafatshme, pra në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 01/2025 per Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave. Ankuesi përveç pretendimit me shkrim nuk e ka mbështetur në asnjë prove ku shihet data e postimit, ndërsa videoja e bashkëngjitur po ashtu nuk provon këtë gjë ndërsa prova e bashkëngjitur nga ana jone e provon të kundërtën, se video e njëjta që ka bashkëngjitur ankuesja është bërë me datë 16.12.2028. Gjithashtu, në përmbajtjen e videos dhe në përshkrimin shoqërues nuk figuron asnjë element i fushatës zgjedhore, përfshirë: numër zgjedhor, slogan. Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se kandidati Shkëmb Manaj nuk e ka publikuar këtë video gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, por me 16 dhjetor 2025 - 1 ditë para hapjes zyrtare te fushatës zgjedhore. Bazuar në këto rrethana, vlerësojmë se veprimi i sipërpërmendur nuk përbën shkelje të dispozitave ligjore që rregullojnë fushatën zgjedhore, dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet aktivitet apo ndikim elektorale i ndaluar. Si dëshmi kanë bashkangjitur provat dhe kërkojnë nga PZAP te refuzohet ankesa e subjektit politik LVV.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës , pretendimeve ankimore, si dhe përgjigjes në ankesë, gjeti se:

**- Ankesa është e pa bazuar**

Parashtruesi i ankesës subjekti politik LVV në ankesën e tij ka theksuar se me datë 27.12.2025, Përparim Rama në cilësinë e Kryetarit të Prishtinës, ka publikuar dhe shpërndarë një video-mesazh politik nga hapësira e zyrës së tij, ku ka bërë thirrje të drejtpërdrejtë për mbështetje dhe votim të kandidatit Shkëmb Manaj dhe të subjektit politik LDK. Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të nenit 36 dhe 37 par. 1 pika 2 i LZP-së, apo të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024. Në rastin konkret nga provat e prezantuara si dëshmi nga ankuesi nuk shihet data 27.12.2025 për të cilën pretendohet si datë e publikimit

të videos nga Kryetari i Prishtinës Përparim Rama, dhe me arsyetimin se e njëjta është shpërndarë nga hapësira e zyrës së tij.

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar, pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur, nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese, pasi që nga provat e administruara, gjegjësisht nga verifikimi i provave nuk ka mundur të vërtetohet se i njëjti video incizim është postuar siç pretendohet në ankesë nga ana e subjektit ankues.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 par.3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 par. 1 të Ligjin Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**

ZP.Anr.52/2025 më datën 30.12.2025

**Kryesues i Panelit,**  
Ramush Bardiqi



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.